



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.10/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarës M.B, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga L.O, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 11.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga L.O, ndaj gjyqtarës M.B, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2022, Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes e-mailit zyrtar, ka përcjellë ankesën disiplinore të parashtruar nga L.O ndaj gjyqtarës M.B, me arsyetimin se familja e saj posedon pronë në sipërfaqe prej 4 hektarë dhe 44 ari, në vendin e quajtur L., Komuna e Pejës, në të cilën M.M ka ndërtuar një shtëpi të re dhe ka uzurpuar një pjesë të tokës dhe se lidhur me pronën në fjalë ekziston Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 21.01.2016, i cili është në favor të familjes së saj, aktgjykimi është pa të drejtë ankese, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet as me mjete të rregullta e as të jashtëzakonshme. E njëjta ka sqaruar se në këtë çështje bëhet fjalë për dy parcela 167/3 dhe 167/28 dhe se para 10 ditësh, nga një person i cili është interesuar që të blejë tokën, ka dëgjuar se M M, me dëshmitar të rremë dhe me gjyqtaren M.B ka marrë 14350 m2 dhe ka krijuar një parcelë të re me numër .../... E njëjta ka theksuar është guxim i madh të nxjerrët një aktgjykim i tillë krahas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë në bazë të dëshmisë se uzurpatori jeton atje, se e ka blerë tokën por, që nuk ka asnjë provë sepse në luftën e vitit 1943, i janë djegur të gjitha letrat e blerjes si dhe vetë shtëpia. Parashtruesja e ankesës, ka theksuar se gjatë këtij gjykimi nuk kanë qenë të informuar nga gjykata për proces gjyqësor, kinse për shkak të numrit të telefonit dhe adresës së panjohur ndërsa, e njëjta ka theksuar se uzurpatori vazhdimisht e ka kontaktuar dhe kërcënuar, situatë kjo që vlerësoni se ngre dyshime për dëshminë e këtij dëshmitari dhe se ka mundësi që dëshmitari ka marr ryshfet. Mbi bazën e të lartcekurave, parashtruesja e ankesës ka kërkuar që të anulohet vendimi i Gjykatës Themelore në Pejë dhe t'i kthehet prona familjes M., e cila i ka të gjitha provat, dokumentet si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Me datë 18.10.2022, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga L.O ndaj gjyqtarës M.B.

Gjyqtarja M.B, në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se ankesa disiplinore e parashtruar ndaj saj është e pa bazë dhe e pa argumentuar, për faktin se si gjyqtare e çështjes ka zhvilluar procedurën sipas padisë së paditësit S.M kundër të paditurve D. V dhe S M dhe pas zhvillimit të procedurës ka marrë aktgjykim me të

cilin në tërësi e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Me rastin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi palët kanë pas të drejtë anekse. Gjyqtarja, ka theksuar se as këtu parashtruesja e ankesës L.O e as personi M M, nuk kanë qenë palë në procedurë në lëndën C.nr.382/20 dhe nëse e njëjta pretendon se i është shkelë ndonjë e drejtë mund të shfrytëzoj mjetet juridike të parapara me LPK.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarës M.B, së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se aneksa disiplinore është e pabazuar për faktin se nuk është mbështetë në asnjë fakt apo provë mbi bazën e së cilës autoriteti kompetent do të bindej për ekzistimin e dyshimit se gjyqtarja M.B së bashku me personin M.M dhe me dëshmitarë të rremë, ka krijuar një parcelë të re në ngastrën kadastrale të parashtrueses së ankesës apo se ka nxjerrë vendim të kundërligjshëm, bazuar në deklarime të pavërteta të ndonjë dëshmitari dhe në kundërshtim me vendimin ekzistues të Gjykatës Supreme.

Sa i përket kërkesës së parashtrueses së ankesës për anulim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë dhe pretendimeve se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë është nxjerrë në kundërshtim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe se i njëjti është nxjerrë në mungesë të provave dhe në shkelje të dispozitave të procedurës, autoriteti kompetent ka gjetur se Gjykata Themelore nuk është kompetente për të anuluar aktgjykime dhe për të vlerësuar shkeljet eventuale të të drejtës materiale apo procedurale.

Pjesa tjetër e ankesës disiplinore, tërësisht përbëhet nga pretendime ankimore të cilat janë objekt vlerësimi i gjykatës së shkallës së dytë, e të cilat nuk mund të konsiderohen shkelje të natyrës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.10/22, me datë 11.11.2022

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarës M.B*
- 3. Parashtrueses së ankesës – Ljiljana Obradovic*